

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Qasja e SPAK ndaj kreut të SHISH i ka lënë pa fjalë partnerët", Rama për Vlora Hysenin: Çështje individuale, por me ekspozimin e dosjes u dëmtua reputacioni i shtetit Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/qasja-e-spak-ndaj-kreut-te-shish-i-ka-lene-pa-fjale-partneret-rama-per-vlora-hysenin-ceshtje-individuele-por-me-ekspozimin-e-dosjes-u-demtua-reputacioni-i-shtetit/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 15:43:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 15:32:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fe447fdae8b0f412028326414487a266c488faa0ca886e8bc634a3098fb386cf
TEKSTI	a90fa0ab341e2be0021735a196c082722922c76e15dd7843f9cdcec31758bdcb
PAMJA	5c0a43edb3cf6876e8fa2aeb959d031ba8caa5477672df97fef3f8c8e8bcdfee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9a1cdc7ebe25f88af1b8eea81e907caa744ae8184838c698863fcb267fd1e858
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c79dfe18abd067ab8b189d0d92c4d66095ab349897e5facabd5b8506753a66f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9a1cdc7ebe25f88af1b8eea81e907caa744ae8184838c698863fcb267fd1e858>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet

“Qasja e SPAK ndaj kreut të SHISH i ka lënë pa fjalë partnerët”, Rama për Vlora Hysenin: Çështje individuale, por me ekspozimin e dosjes u dëmtua reputacioni i shtetit



Edi Hallaci

27 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Kryeministri Edi Rama ka reaguar lidhur me çështjen e kreut të Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hysenit, duke bërë një dallim mes procesit individual të drejtësisë dhe shqetësimeve që, sipas tij, lidhen me mënyrën se si është administruar dhe ekspozuar dosja hetimore.

Rama thekson se qëndrimi i tij dhe i shumicës qeverisëse ndaj çështjeve individuale të drejtësisë mbetet respektimi i pavarësisë së institucioneve dhe zhvillimi i procesit në rrugë gjyqësore.

Në të njëjtën kohë, kreu i qeverisë shprehet se rasti ngre edhe një çështje me karakter shtetëror, për shkak të ndjeshmërisë së institucionit që drejton Hyseni. Sipas **Ramës**, ekspozimi i të dhënave të dosjes hetimore ka krijuar potencial për dëmtimin e reputacionit të shtetit dhe ka prekur një institucion me rëndësi të veçantë për sigurinë kombëtare.

Rama e lidh këtë situatë edhe me marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë, duke deklaruar se mënyra e trajtimit të çështjes, sipas tij, ka shkaktuar shqetësim edhe te partnerët e Shqipërisë.

Pjesë nga fjala e Ramës:

Çdo akuzë e ngritur, ndaj kujtdoqoftë, duhet të provohet ose të rrëzohet përmes një procesi të pavarur, të paanshëm dhe të rregullt gjyqësor. Çdo masë kufizimi e lirisë nga organi i akuzës, për cilindoqoftë që nuk ka imunitet parlamentar, kundërshtohet vetëm në gjykatë, jo në podiumin e Kryeministrit, as në foltoret e politikës.

Këto piketa të vijës së siellies sime e të shumicës qeverisëse ndaj çështjeve individuale të drejtësisë

kanë qenë dhe mbeten kështu. Për të gjithë. Por nga ana tjetër, respekti për pavarësinë e drejtësisë, nuk do të thotë heshtje edhe kur një shqetësim parimor shfaqet gjatë veprimtarisë së organeve të saj. Konkretisht, në këtë rast, përveç dhe përtej çështjes penale individuale, ka një fakt tjetër parimor, shtetëror, që s'mund të anashkalohej sikur nuk ka ndodhur.

Gjatë marrjes së masës dhe administrimit gjyqësor të dosjes, një institucion me ndjeshmëri të veçantë për sigurinë dhe reputacionin e shtetit, u ekspozua. U ekspozua ndaj potencialit të një dëmi të madh, i cili mund dhe duhej të ishte parandaluar plotësisht.

U desh, që të dhëna të dosjes hetimore, të vërshonin nëpër kanale sociale e tezga mediatike, përpara se sa gjykata të urdhëronte, si kofini pas të vjelit, kufizimin e publikimit të tyre. Natyrisht pa asnjë sukses.

Kur puna e sjell që hetimi të ngjitet tek kreu i shërbimit inteligjent të vendit, atëherë ky nuk është më problemi i një pushteti të pavarur. Ky është një problem i krejt shtetit dhe prandaj edhe kjo qasje e lëshuar, si pa duar, i ka lënë pa fjalë edhe të gjithë partnerët tanë.

Me fjalë të tjera, nuk është me siguri hera e parë në historinë e botës, që shefi i shërbimit sekret merret i pandehur, por është hera e parë në historinë e botës, që institucioni i shërbimit sekret bëhet target kombëtar e ndërkombëtar thashethemesh mediatike, për shkak të mosmarrjes së asnjërës prej masave, që shtetet marrin në një rast kaq fatkeq sa ky.

LAJME TË NGJASHME



FJALAE PLOTË/ “Si ka mundësi që nuk e dija?” Rama: Kam fajet e mia, por jam këtu për të bërë histori e jo pasuri

23 MIN



Rama: Nuk ka bir nëne të ketë një provë që ju kam marrë një qindarkë

1.5 MIN



Anulimi i konferencës së kryeministrit Rama në Rinas, reagon Berisha: Kapitullim pa kushte para mediave

1.5 MIN



“Orët më janë dhuruar nga miq të fuqishëm”, Rama: I kam regjistruar si prona të shtetit

1.5 MIN



“Korrupsioni nuk po shtohet, po goditet”, Rama: Hetimet e drejtësisë, si dëshmi e një kapitulli të ri

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Punë e paqëndrueshme dhe



Gjiganti italian i modës Gucci



Tanimë gjërat kanë



Nations League, sonte



Aksident në Fushë-

pension i hershem, studimi
zbulon lidhjen me plakjen e
trurit!

nxjerr në treg atijete "Made in
China"!

ndryshuar/Shenjat e zodiakut që
më në fund po fillojnë një
kapitull të ri të jetës së tyre!

SHQIPERI vs.
BJELLORUSI/Ekskluzivisht në
DigitAlb!

Kruje/Perpiasen 3 automjete,
humb jetën një 19-vjeçar!



A ju ndodh të shihni të njëjtën
ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund
të fshihet pas saj?




Cindy Crawford përjetoi vite të
vështira për djalën e saj?



Madonna tërheq vëmendjen me
fotografi provokuese, pozon me
reçipeta transparente?



"The Real Rooneys" përballtet
me kritika? A është jeta e Wayne
dhe Coleen Rooney vërtetë kaq
autentike?



"Send Nudes"? Sydney Sweeney
shfaqet provokuese në një tjetër
fushatë?

EDITORI SUGJERON



Apple surprizon me risitë, AI bën
gabimin e frikshëm dhe Tesla
rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja
se kur tradhetojnë çiftet në një
lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla
Roadster rikthehet me një
premtim të çmendur: Makina që
mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI
ngriti në këmbë ushtrinë e
SHBA-së, gati për sulm! Ja si
ndodhi gjithçka...



Apple Watch tani "dëgjon"
bisedat tuaja dhe i përmbledh për
ju? Risia që po ngre
pikëpyetje...



Keni renë në dashuri?! Apo është
thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-
in dhe vjen me "iPhone Duo"...
por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave
përdorimi/ A ia vlen vërtetë ta
ndërroni telefonin sipas Mateo
Kadriut...



Do të habiteni kur të zbuloni
fuqinë e kanellës!



A mund të konsumoni kafe gjatë
ushqyerjes në gjii? Ja se çfarë
thotë studimi...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informativ dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.